



**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE  
STATISTIKAVE BUJQËSORE**

# **ANALIZA E TREGUT TË QEPËS**

**Shkurt, 2019**

## Parathënie

Perimtaria është një sektor i rëndësishëm dhe me ndikim shumë të madh për zhvillimin ekonomik në vendin tonë, i cili mundëson vende të reja të punës dhe rritje të të ardhurave familjare. Kosova ka një traditë shumëvjeçare në kultivimin e qepës. Edhe pse prodhimtaria vendore pothuajse e mbulon mjaftueshëm konsumin vendor, Kosova ende vazhdon të importoj qepë për t'i plotësuar kërkesat vendore për konsum.

## Tregu i qepës

Në Kosovë qepa ka një prodhimtari mesatarisht të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat vendore për konsum. Duke shikuar të dhënat e pesë viteve të fundit shohim se në vitin 2017 prodhimtaria e qepës arriti në 22,436 tonë,

## 1 Prodhimtaria vendore


Në vitin 2017 në Kosovë ishin të mbjellur 1,465 ha me qepë. Prodhimtaria totale në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 shënoi

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore ka analizuar të gjitha të dhënat statistikore për qepën në Kosovë, ku në këtë analizë shtjellohen më gjerësisht të dhënat mbi prodhimtarin vendore, zhvillimin e tregtisë, çmimet e qepës vendore dhe atyre të importuara, madhësia e tregut, dhe mbështetja e prodhimtarisë së qepës.

e që është më e larta krahasuar më vitet e mëparshme. Krahas prodhimit vendor Kosova vazhdon të importon ende një sasi të qepës për përmbushjen e tërësishme të nevojave për konsum vendor.

rritje prej 13%, kjo erdhi si rezultat i rritjes së sipërfaqes së kultivuar për 237 ha.

Figura 1: Sipërfaqja dhe prodhimtaria e qepës, 2012-2017




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në figurën e mëposhtme është paraqitur sipërfaqja e kultivuar me qepë sipas regjioneve, ku shihet se regjioni në të cilin më së shumti kultivohet qepa është

Gjakova me 37%, pasuar nga Prishtina me 18%, Mitrovica 16%, Prizreni 14% dhe regjionet tjera si Peja, Gjilani dhe Ferizaj me përqindje më të vogël.

**Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me qepë sipas regjioneve në vitin 2014**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Prodhimtaria vendore e qepës mund të ndahet edhe në bazë të komunave, ku në figurën e mëposhtme janë paraqitur 10 komunat në të cilat më së shumti kultivohet qepa. Totali i sipërfaqes së kultivuar për këto komuna ishte 834 ha apo 80% e gjithsej sipërfaqes së kultivuar

me qepë. Rahoveci karakterizohet me sipërfaqen më të madhe (308 ha), pasuar nga Vushtrria (131 ha) dhe qytetet tjera si Suhareka, Podujeva, Gjakova, Lipjani, Peja, Prizreni dhe Istogu, me sipërfaqe më të vogël.

**Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me qepë sipas komunave në vitin 2014**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

## 2 Zhvillimi i tregtisë

Mund të themi se Kosova sa i përket tregut të qepës e mbulon një pjesë të konsiderueshme të tregut vendor, ku në vitin 2017 shkalla e vetëmjaftueshmërisë ishte 84%. Për të përmbushur nevojat vendore, Kosova vazhdon të importoj


### 2.1 Importi i qepës

Importi i qepës në vitin 2017 ishte 4,319 tonë, që për dallim nga viti 2016, kishte rënie të sasisë së importuar për 11%. Në periudhën '12-'17, sasia mesatare e importuar e qepës ishte rreth 4,891 tonë. Vlera e importit të qepës në vitin 2017 ishte rreth 1.7 mil. €, ku në krahasim me

qepë prej vendeve tjera. Sa i përket sasisë së eksportit ka pasur luhatje për periudhën '12-'17, ndërsa nëse krahasojmë vetëm dy vitet e fundit, në vitin 2017 kishte rritje të eksportit për 77%.

vitin 2016 ishte për 19% më e ulët. Kjo është për shkak të sasisë më të vogël të importuar në vitin 2017, por edhe nga ajo se çmimi për njësi (kg) të importuar ishte për 0.04 € më i ulët. Në periudhën '12-'17 çmimi mesatar për njësi të qepës së importuar ishte 0.36 €/kg.

Figura 4: Importi i qepës 2012-2017, në tonë (majtas) dhe në '000 € (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vendet nga të cilat më së shumti është importuar qepë gjatë periudhës '16-'17 janë: Holanda, Maqedonia, Shqipëria,

Serbia, Polonia dhe vendet tjera me një përqindje më të vogël si: Franca, Turqia, Austria, Egjipti etj.

Figura 5: Importi i qepës 2016-2017, sipas vendeve




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

## 2.2 Eksporti i qepës

Në Kosovë eksporti i qepës gjatë pesë viteve të fundit kishte një luhajtje të konsiderueshme ndër vite. Në vitin 2017 eksporti i qepës ishte 38 tonë, ku për dallim nga viti 2016, kjo sasi është më e madhe për 77%. Gjatë periudhës '12-'17 sasia më e madhe e eksportuar ishte në vitin 2013, e që arriti në 308 tonë. Vlera e

eksportit të qepës në vitin 2017 ishte 9,000 €, ku mesatarja e çmimit për njësi të eksportuar në periudhën '12-'17 ishte 0.22 €/kg, ndërsa çmimi për njësi (kg) të eksportuar në vitin 2017 ishte 0.24 €/kg apo për 0.07 €/kg më i lartë sesa në vitin 2016.

Figura 6: Eksporti i qepës 2012-2017, në tonë (majtas) dhe në '000 € (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i qepës sipas vendeve në vitin 2016, është realizuar me një përqindje më të madhe në Malin e Zi (77%) pasuar nga Shqipëria (17%) dhe Gjermania (6%). Në

vitin 2017, Kosova ka eksportuar në Poloni 89% të gjithëj sasisë së eksportuar, në Gjermani 6% dhe në Suedi 5%.

**Figura 7: Eksporti i qepës 2016-2017, sipas vendeve**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

### 2.3 Bilanci tregtar i qepës

Duke shikuar në figurën e mëposhtme shohim se Kosova gjatë viteve '12-'17 kishte një bilanc tregtar negativ të qepës, ku vlera më e lartë është ajo e vitit 2016, (2,042 €). Prodhimtaria vendore në vitin 2017 ka qenë 22,436 tonë. Sa i përket eksportit është një përqindje e ulët e mbulueshmërisë së importit në të gjitha vitet. Qepa e importuar vazhdon të jetë ende prezente në tregun tonë sepse

prodhimtaria vendore përmbush mbi 80% të nevojave për konsum. Gjatë periudhës '12-'17, mesatarisht përmbushja e nevojave të tregut nga prodhimtaria vendore është rreth 75%. Pamundësia e plotësimit të kërkesave vendore tregon se në Kosovë ka nevojë për rritje të sipërfaqes së kultivuar me qepë në mënyrë që të përmirësojmë bilancin tregtar dhe të plotësojmë kërkesat vendore.

Figura 8: Bilanci tregtar i qepës 2012-2017, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

### 3 Çmimet e tregut

Në tregun tonë kultura e qepës është e pranishme pothuajse gjatë tërë vitit. Përveç qepës vendore, në treg gjendet edhe qepa e importuar nga vendet e tjera. Sasia më e madhe e qepës vendore dhe

asaj të importuar përdoret për konsum njerëzor. Çmimi mesatar me shumicë gjatë viteve '12-'17 ka qenë 0.34 €/kg, ndërsa çmimi mesatar me pakicë 0.41 €/kg.


#### 3.1 Çmimet në tregun vendor

Në figurën e mëposhtme janë të paraqitura çmimet vendore të konsumit (minimale dhe maksimale) të qepës për periudhën '12-'17. Çmimi minimal për kulturën e qepës në tregun vendor me shumicë ka

qenë 0.24 €/kg, ndërsa çmimi maksimal 0.45 €/kg. Çmimi minimal me pakicë ka qenë 0.30 €/kg, kurse ai maksimal 0.55 €/kg.



Figura 9: Çmimet vendore '12-'17, (€/kg)




Burimi: DAESB-MBPZHR

### 3.2 Çmimet e importit

Çmimet e importit me shumicë dhe pakicë për periudhën '12-'17, janë paraqitur në figurën e mëposhtme. Gjatë kësaj periudhe shohim se viti 2013, në krahasim me vitet tjera kishte çmimin më të lartë të çmimit

me shumicë dhe të atij me pakicë. Çmimi minimal me shumicë ka qenë 0.32 €/kg, kurse ai maksimal 0.58 €/kg, ndërsa sa i përket çmimeve me pakicë, minimalja ishte 0.39 €/kg dhe maksimalja 0.75 €/kg.

Figura 10: Çmimet e importit '12-'17, (€/kg)



Burimi: DAESB-MBPZHR

## 4 Madhësia e tregut

Tregu i përgjithshëm i qepës në Kosovë përveç prodhimitarisë vendore përmban edhe qepë të importuar për përmbushje të nevojave për konsum vendor. Përdorimi vendor duke përfshirë prodhimitarinë vendore dhe importin si dhe duke përjashtuar sasinë e eksportuar në vitin

2017 ka qenë 26,717 tonë, ku me prodhim vendor mbulohej 84% të nevojave për konsum. Duke u bazuar në të dhënat e prodhimitarisë vendore si dhe në të dhënat e tregtisë për vitin 2017, rezultoi që konsumi i përgjithshëm i qepës për kokë banori në Kosovë është rreth 15 kg në vit.

### 4.1 Mbështetja e prodhimitarisë së qepës

#### 4.1.1 Pagesat direkte për qepën

Në sektorin e perimeve në fushë të hapur hynë edhe qepa si kulturë e subvencionuar. Objektivat që synohen të arrihen përmes pagesave direkte në sektorin e perimeve janë: rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, siguri e ushqimit, rritja e të ardhurave dhe zvogëlimi i shpenzimeve. Fermerët të cilët janë kultivues të qepës në fushë të hapur, mund të përfitojnë nëse i plotësojnë kriteret e përgjithshme të

parapara në Programin e Pagesave Direkte si dhe kriteret specifike si: të kenë të mbjellur së paku 0.50 ha me qepë në fushë të hapur, sipërfaqja duhet të jetë minimum 0.20 ha parcelë e pandarë dhe nëse është e marrë me qira të jetë e kontraktuar së paku për 1 vit. Mbështetja e fermerëve përmes pagesave direkte bëhet për sipërfaqe të mbjellur me qepë në fushë të hapur, dhe në vitin 2017 mbështetja ishte në vlerë prej 300 €/ha.

## 5 Konkluzione

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë për analizën e tregut të qepës, shohim se Kosova mbulon mbi 80% të nevojave për konsum, por për t'i përmbushur nevojat e tregut në tërësi, vazhdimisht është importuar. Meqenëse qepa është ndër kulturat kryesore dhe shumë e rëndësishme në kulinari, mbështetja për këtë kulturë duhet të vazhdojë edhe më tutje dhe të stimulohen fermerët që të vazhdojnë t'i rrisin sipërfaqet e kultivuare me qepën. Në këtë

mënyrë do të rritej prodhimitaria vendore dhe do të plotësoheshin nevojat për konsumin vendor të qepës. Gjithashtu me rritjen e prodhimit dhe plotësimin e nevojave vendore, do të rritej edhe eksporti i kësaj kulture. Përkrahja e prodhuesve vendor përmes fushatave vetëdijesuese dhe aktiviteteve promovuese luan rol të rëndësishëm si në rritje të prodhimit vendor po ashtu edhe të konsumit.